

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Për: Panelin e Gjykatës së Apelit

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatës Nina Jorgensen

Administratorja: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Mbrojtësi i specializuar për Hysni Gucatin

Data: 13 gusht 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Version i Redaktuar Publik i Kundërpërgjigjes ndaj përgjigjes së Prokurorisë
ndaj apeleve të Mbrojtjes kundër vendimit në lidhje me nxjerrjen e materialit**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësi i Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli

Mbrojtësit të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

I. HYRJE

1. Mbrojtësi i specializuar për z. Haradinaj kërkon t'i kundërpërgjigjet përgjigjes¹ së Zyrës së Prokurorit të Specializuar të datës 8 korrik 2021 ndaj apeleve të Mbrojtjes.²
2. Fillimisht, mbrojtësi i specializuar për z. Haradinaj vëren me shumë keqardhje dhe nuk pajtohet me tonin veçanërisht armiqësor dhe përçmues në përgjigjen e ZPS-së, që, fatkeqësisht, nuk është hera e parë që përdoret ndaj mbrojtësve të specializuar.³ Është për të ardhur keq që kjo çështje është kthyer në një temë të zakonshme debati në Dhomat e Specializuara, që, me kalimin e kohës, është përkeqësuar deri në atë shkallë saqë parashtrimet, qofshin këto publike ose jo, përmbajnë pretendime për kundërvajtje ose parregullsi. ZPS-ja duhet të pranojë se procedurat gjyqësore në Dhomat e Specializuara kanë natyrë ballafaquese.
3. Mbrojtësit e specializuar e kuptojnë, dhe deri në një shkallë e mirëkuptojnë, që ZPS-ja është e pakënaqur me përpjekjet e Mbrojtjes për të paraqitur argumentet sipas udhëzimeve të klientit, përfshi kërkimin e informacioneve

¹ KSC-BC-2020-07/IA005/F00005.

² Njoftim për apel të ndërmjetëm lejuar në bazë të vendimit KSC-BC-2020-07/F00210 në pajtim me nenin 45(2) dhe rregullën 170(2), KSC-BC-2020-07/IA005/F00002, 25 qershor 2021, konfidencial ("apeli i Gucatit"); Parashtrime lidhur me apelimin e vendimit KSC-BC-2020-07/F00210, KSC-BC-2020-07/IA005/F00003, 25 qershor 2021, konfidenciale ("apeli i Haradinajt", së bashku me apelin e Gucatit: "apelet e Mbrojtjes").

³ Fjalët që i ka drejtuar ZPS-ja Mbrojtjes, ndër të tjera drejtpërdrejt Mbrojtjes së Haradinajt përfshijnë: "mangësi" (para. 16), "absurditet" (para. 20), "të pavlera", "të pabaza" (para. 34), "kundërshtime jorealiste" (para. 35), "I vetmi kufi do të ishte imagjinata e Mbrojtjes" (para. 35).

të arsyeshme që mund ta vënë ZPS-në në vështirësi, por që janë pjesë e nevojshme e argumenteve të Mbrojtjes. Sidoqoftë, parashtrohet se pyetjeve të tilla duhet t'u jepet përgjigje në mënyrë serioze, me respekt dhe profesionalizëm. Në të kundërt, rrezikon të diskreditohet institucioni.

4. Siç argumentohet në apelet e Mbrojtjes, jemi të mendimit që materialet që janë kërkuar të nxirren, janë të rëndësishme dhe juridikisht thelbësore për përgatitjen e mbrojtjes.
5. Mbrojtja e z. Haradinaj do t'i kufizojë parashtrimet më poshtë vetëm për t'iu përgjigjur pikave të ngritura në përgjigjen e ZPS-së.

II. HISTORIKU

6. Historiku përkatës është paraqitur në apelet e Mbrojtjes dhe nuk përsëritet këtu.

III. DISPOZITAT LIGJORE

7. Dispozitat ligjore përkatëse janë paraqitur në apelet e Mbrojtjes dhe nuk përsëriten këtu.

IV. PARASHTRIMET

A. Rëndësia e materialeve për argumentet e Mbrojtjes lidhur me shtytjen për kryerje të veprës penale

8. Në paragrafin 19, ZPS-ja pretendon se nuk ka asnjë provë për shtytje për kryerje të veprës penale.⁴
9. Pikësëpari, nuk i takon ZPS-së ta marrë këtë vendim, sepse të pranosh këtë faktikisht nënkupton që një institucion lejohet të hetojë vetveten. Prandaj, përsërisim parashtrimet e paraqitura në të shkuarën se nuk i takon ZPS-së të përcaktojë se çfarë materiali është i përshtatshëm për t'u nxjerrë dhe çfarë jo.
10. Gjithashtu, me gjithë respektin, argumenti i ZPS-së nuk mbështetet as me prova dhe as me përpjekje për të vërtetuar të kundërtën. Po ashtu, deklaratat kategorike të këtij lloji nuk gëzojnë më ndonjë farë besueshmërie mes mbrojtësve: në mënyrë të përsëritur, konferencë pas konference për ecurinë e çështjes gjyqësore, përfshirë edhe në seanca publike, ZPS-ja e ka siguruar Mbrojtjen dhe Gjykatësin e Procedurës Paraprake se kishte zbatuar plotësisht detyrimet për nxjerrjen e materialit, vetëm për të nxjerrë më pas me dhjetëra mijëra faqe materiale të tjera për Mbrojtjen.

⁴ Përgjigjja, para. 19.

11. Në çdo rast të ngjashëm kur ka rrjedhje të mijëra faqeve materiali “të ndjeshëm” ose “konfidencial”, çdo organ hetues profesional, për të mos lejuar që të përsëritet rast i ngjashëm në të ardhmen, do të bënte atë që di të bëjë më mirë: të hetojë dhe të kryejë, më së paku, një hetim të brendshëm për rrjedhjen e materialit dhe personat përgjegjës. Nuk është e qartë nëse është kryer ky hetim, por sinqerisht do të ishte shumë e rëndë nëse nuk është bërë, ndaj po merret si e mirëqenë që është kryer një lloj hetimi i brendshëm për rrjedhjen e materialit. Sigurisht, në një rast të tillë, çfarëdo të dhënash tejet të ndjeshme të hetimit mund të nxirren, për shembull, me redaktimet e duhura, në vend të refuzimit të përgjithshëm mbi bazat e relevancës.
12. Më pas, në paragrafin 20 të përgjigjes, ZPS-ja e keqinterpreton tërësisht parashtrimin e Mbrojtjes së Haradinajt dhe e etiketon si “absurd”. Kjo gjuhë nuk është e dobishme, e megjithatë është tregues i sjelljes përbuzëse me të cilën përballet shpesh Mbrojtja. Për më tepër, në parashtrimet e Mbrojtjes së Haradinajt, në paragrafët e cituar, nuk thuhet se ZPS-ja “ka mungesë të perceptuar interesi për parandalimin ose pengimin e ‘rrjedhjeve’”. Nuk është thënë asgjë për mendësinë e asnjë individi apo për “mungesë të perceptuar interesi.” Përkundrazi, Mbrojtja paraqet një argumentim logjik që mëton t’i tregojë Panelit të Gjykatës së Apelit se është thjesht e habitshme dhe e pashpjegueshme që nuk është bërë asgjë për të hetuar lënien e paketave me dokumente tek OVL-UÇK-ja.

13. Në paragrafin 21 dhe sërish në paragrafin 23, ZPS-ja pretendon se nuk është e mundur nga ana faktike të ngrihet argumenti për nxitje ose shtytje. Me gjithë respektin, ky nuk është një vlerësim apo vendim faktik që i takon ZPS-së, por Gjykatës.
14. Në paragrafin 21 të përgjigjes së saj, ZPS-ja pretendon se deklaratat e të akuzuarve e bëjnë të qartë se ata nuk i njohin personat që ua sollën dokumentet dhe se nuk kanë pasur asnjë lloj ndërveprimi me ta; kjo nuk e bën të pavlefshëm pretendimin e mbrojtjes për shtytje për kryerje të veprës penale; më konkretisht, ZPS-ja nuk jep sqarim të mëtëjshëm se si e ka kryer vlerësimin e standardit përkatës për demonstrimin e shtytjes për kryerje të veprës penale, dhe rrjedhimisht parashtrimet e saj lidhur me këtë pikë duhen hedhur poshtë.
15. Nga paragrafi 24 e më poshtë, ZPS-ja mbështetet shumë në çështjen *M v. Netherlands*⁵ në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (“GJEDNJ”) për të mbështetur pretendimin e saj se nuk ka pse të nxirret raporti i hetimit të brendshëm. Me përpjekjet e saj për të sugjeruar se çështja konkrete është e ngjashme me çështjen *M v. Netherlands*, ZPS-ja e ka vënë veten në pozitë të vështirë.
- a. *Së pari*, ZPS-ja nuk arrin të bëjë dallimin themelor mes *M v. Netherlands* dhe çështjes konkrete. Në fakt, siç citon edhe ZPS-ja, GJEDNJ-ja

⁵ ECtHR/GJEDNJ, *M v. The Netherlands*, 2156/10, Aktgjykimi, 25 korrik 2017.

konstatoi se as prokuroria dhe as gjykata nuk e kishin pasur raportin e pretenduar të hetimit të brendshëm të shërbimit sekret, e as nuk ishte e mundur që këto dy institucione të përcaktonin nëse ai kishte ekzistuar në të vërtetë. Ndërsa në çështjen konkrete, i vetmi institucion për të cilin bëhet fjalë është ZPS-ja, dhe ajo i mban vetë në ruajtje raportet e veta hetimore. Natyrisht që një prokuror ose gjykatës holandez mund të mos jetë në gjendje të vërtetojë ekzistencën e një raporti të hetimit të brendshëm të përgatitur nga shërbimi sekret holandez, thjesht sepse janë dy institucione krejtësisht të ndara, si dhe për shkak të natyrës dhe ligjeve të punës së shërbimit sekret. Sidoqoftë ky nuk aspak është rasti në çështjen konkrete dhe, rrjedhimisht, ZPS-ja nuk mund të mbështetet te *M v. Netherlands* për të refuzuar nxjerrjen e raportit të hetimit të brendshëm.

- b. *Së dyti*, një dallim i rëndësishëm është se dokumentet sekrete ose konfidenciale të çështjes *M v. Netherlands* iu bënë të disponueshme të pandehurit për të përgatitur mbrojtjen, dhe jo si në çështjen konkrete, ku nuk është vënë në dispozicion asnjë dokument. Duhet vënë në dukje se dokumentet në çështjen *M v. Netherlands* ishin dokumente të klasifikuara nga shërbimi sekret, që përmbanin sekrete shtetërore. Këto dokumente u nxorën me redaktimet e duhura për qëllime të procedimit penal. Nuk ka arsye pse të mos zbatohet praktika e redaktimit edhe në çështjen

konkrete. Në procedurat para DHK-së, ZSP-ja nuk mund të pretendojë nivel më të lartë fshehtësie të dokumenteve të saj sesa niveli i fshehtësisë së shërbimit sekret.

16. Ftohet Paneli i Apelit të shqyrtojë dallimet e konsiderueshme mes çështjes konkrete dhe *M v. Netherlands* dhe të vendosë që kjo e fundit nuk mund të përdoret si precedent.

B. Rëndësia materiale e dokumenteve që kërkohen për përgatitjen e

Mbrojtjes

17. Në paragrafin 30 të përgjigjes, ZPS-ja argumenton që, sipas akuzave, nuk ka rëndësi mënyra si e mori i akuzuari informacionin konfidencial. Sërish, Mbrojtja për z. Haradinaj nuk mendon se kjo është një çështje për të cilën vendos ZPS-ja, por Gjykata. Argumenti lidhur me rëndësinë materiale të dokumenteve për të pandehurin dhe mbrojtjen e tij qëndron.
18. Së fundi, parashtrimet emocionale të ZPS-së në paragrafët 35-36 të përgjigjes së saj duhen trajtuar shkurtimisht. Gjithashtu, vetëm paragrafi i parafundit⁶ i ZPS-së tregon se cila mund të jetë arsyeja e vërtetë për mosnxjerrjen e informacionit për rrjedhjen dhe lënien e materialeve: pretendohet se nxjerrja e një informacioni të tillë do të rrezikonte [REDAKTUAR].

⁶ Përgjigjja, para.36

19. Për t'u përgjigjur thjesht, Mbrojtja e z. Haradinaj fton Gjykatën të mos marrë parasysh këto deklaratat hiperbolike dhe të pabaza, por në vend të tyre të vendosë bazuar në parashtrime, dispozita ligjore dhe fakte, në interes të drejtësisë dhe në interes të të drejtave të akuzuarit për t'u përgatitur siç duhet për mbrojtjen dhe për të pasur një gjykim të drejtë..
20. Pra, bëhet fjalë për drejtësinë e procesit; nëse nuk mund të garantohet një gjykim i drejtë, atëherë nuk duhet të ketë fare gjykim. ZPS-ja nuk mund të fshihet pas [REDAKTUAR] për të justifikuar mosrespektimin e parimeve të drejtësisë në çështjen konkrete.

V. PËRFUNDIM

21. Procesi përmes së cilit dokumentet rrodhën dhe u lanë në zyrat e OVL-UÇK-së është relevant dhe me rëndësi materiale që "saktësisht dhe tërësisht [të vërtetohen] faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm"⁷ – që, sipas së drejtës kosovare, është detyrim për prokurorinë dhe gjykatën.
22. Për arsyet e përmendura më lart, duhen rrëzuar argumentet e ZPS-së, të miratohet apeli i Mbrojtjes dhe të autorizohet nxjerrja e materialeve.

Numri i fjalëve në origjinal: 1649

/nënshkrimi/

/nënshkrimi/

⁷ Neni 7(1) i Kodit të Procedurës Penale në Kosovë.

Tobi Kadman

Mbrojtës i specializuar

Karl Bakli

Bashkëmbrojtës i specializuar